



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.05.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kryetarin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, zotin Ilir Zela, për shqyrtimin e raportit vjetor të AKEP-it për vitin 2018. (*Komisioni përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani dhe Nimet Musaj.

Mungojnë:

Lefter Koka.

Të ftuar:

Ilir Zela – Kryetar i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Altin Rrapaj – Përfaqësues nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Edlira Dvorani – Anëtare e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Xhoana Lilaj – Anëtare e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Eriola Mosko – Shefe kabineti në AKEP

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Sot është data 7 maj, ora 11:00.

Në seancën e sotme kemi një dëgjuesë me kryetarin e AKEP-it, zotin Ilir Zela, për shqyrtimin e raportit vjetor të AKEP-it për vitin 2018.

Relatore është zonja Eglantina Gjermeni.

Prezent është kryetari i AKEP-it, si dhe 4 përfaqësues të tjerë, Altin Rrapaj, Edlira Dvorani, Xhoana Lilaj dhe Eriola Mosko.

Fillojmë me një hyrje të shkurtër nga relatorja, zonja Gjermeni. Më pas do të dëgjojmë prezantimin e raportit nga kryetari dhe do të vijojmë me pyetjet dhe përgjigjet.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni - Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Meqenëse raporti ishte goxha voluminoz, së bashku me shërbimet e Kuvendit kemi punuar për të nxjerrë arritjet e AKEP-it gjatë vitit 2018, problematikat që kanë hasur, vështirësitë, sfidat me të cilat është përballur, mënyrën se si AKEP-i u është përgjigjur atyre, si dhe nëse i ka realizuar rekomandimet që ka dhënë parlamenti në rezolutën e vitit të kaluar.

Kemi përgatitur një projektrezolutë për këtë vit, duke parashtruar sfidat për zgjidhje nga AKEP-i, si dhe duke vlerësuar gjithçka të mirë që është bërë gjatë vitit të kaluar.

Së pari, do të doja t'ju falënderoja për punën gjatë gjithë vitit, si institucion i pavarur, por edhe sepse jeni përpjekur maksimalisht për të realizuar rekomandimet që ka bërë parlamenti në rezolutën e vitit të kaluar!

Në mënyrë të veçantë, do të doja të vlerësoja punën dhe kontributin konkret që ka dhënë AKEP-i në miratimin e ndryshimeve ligjore, të cilat i hapin rrugë lehtësimit të tarifave *roaming* me Kosovën dhe vendet e tjera të rajonit, që, sipas raportit, me Kosovën hapen në mes të qershorit.

Dua t'ju falënderoj personalisht edhe në emër të komisionit! Besoj se kjo është një arritje, paksa e vonuar, por është bërë falë punës dhe angazhimit tuaj.

Për sa u përket arritjeve të tjera, doja të vlerësoja si shumë pozitiv implementimin e ndryshimeve të miratuara për portabilitetin e numrave të pajtimtarëve. Këto ndryshime kanë reduktuar ndjeshëm kohën e portimit për konsumatorët dhe kanë lehtësuar procedurat.

Besoj se ky është një kontribut i rëndësishëm në mbrojtje të konsumatorit, bazuar edhe në rekomandimet që ne, si komision, por edhe parlamenti, kemi dhënë vitin e kaluar.

Si shumë pozitiv dhe me ndikim të drejtë te konsumatorët, do të vlerësoja edhe rikthimin e kohëzgjatjes mujore 30-ditore të paketave të ofruara nga operatorët, që më parë ishin 28-ditore. Kjo vlerësohet nga komisioni, si dhe nga konsumatorët.

Ndërkohë, puna dhe kontributi juaj për një strukturë të re për AKEP-in, e cila u miratua vitin e kaluar nga ne, pasi u propozua nga ju, u realizua brenda vitit të kaluar. Besoj se kjo ka rritur efikasitetin e institucionit dhe shërbimet që kryen.

Gjithashtu, do të doja të vlerësoja ndryshimet në faqen e internetit për ta bërë më të aksesueshëm edhe më praktik informacionin që jepet për të gjithë konsumatorët.

Kam një sugjerim sa i përket linkut të testimit të shpejtësisë së internetit, i cili duhet bërë funksional.

Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me disa institucione sidomos me Autoritetin e Konkurrencës, gjithashtu duhet vlerësuar. Bashkëpunimi i ngushtë me Autoritetin e Medieve Audiovizive në luftën kundër piraterisë mendoj se është një hap i rëndësishëm për punën tuaj, por edhe rritja e inspektimeve në terren është një vlerë pozitive e punës suaj.

Krahas arritjeve do të doja të përmendja disa nga sfidat me të cilat ju jeni përballur. Një nga këto është vendimmarrja për analizën e tregut celular me shumicë, aksesit dhe origjinimit të tregut me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregut me pakicë të shërbimeve celulare, duke iu përgjigjur standardeve dhe sugjerimeve të Bashkimit Europian edhe në raportet e progresit.

Doja t'ju sillja në vëmendje faktin që në raportin e tregut celular që është bërë vitin e kaluar pati një vendimmarrje, e cila u mor nga ju, por më pas u tërhoq. Unë mendoj se kjo nuk është serioze. Mund të ketë pasur faktorë ose kushte specifike, por mendoj se përgjegjësia juaj si institucion i pavarur është që, së pari, t'i merrni në konsideratë mendimet dhe sugjerimet e të gjithë aktorëve para se të bëni vendimmarrjen dhe jo pasi ka reagime nga tregu.

Gjithashtu, ajo që më ka mbetur në mendje nga raporti është pjesa e gjithë faktorëve që kanë ndjeshmëri nga publiku sa i përket përdorimit të infrastrukturës nga shumë operatorë. Në çdo pjesë të Shqipërisë kemi shtylla të vendosura nga kompani të ndryshme, ndërkohë që përgjegjësia dhe autoriteti juaj duhet të bënte të mundur koordinimin.

Ajo që do të doja të sugjeroja dhe ta diskutonim më me hollësi në pjesën e rezolutës është politika mbrojtëse, pra puna që duhet të bëni për ngritjen e një regjistri në kuptimin që

ne, qytetarët të mos kemi shqetësimin të na telefonojnë kompani të ndryshme dhe të na shqetësojnë në çdo orë të ditës ose natës. Sipas mendimit tim AKEP-i, duhet ta ketë hapësirën dhe mundësinë, mund të jetë një përvojë e re, por ky është vetëm një nga një sugjerimet që unë mendoj se është i arritshëm dhe prandaj e kemi vënë te projektrezoluta.

Së fundi, unë do të doja t'ju falënderoja!

Niko Peleshi- Faleminderit zonja Gjermani!

Fjalën e ka zoti Zela.

Ilir Zela – Faleminderit!

Raporti që kemi paraqitur bazohet në legjislacionin në fuqi, njëkohësisht edhe në një praktikë shumë të mirë të shkëmbimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it me komisionin tuaj, si dhe me komisionet e tjera në Kuvend, por edhe me shërbimin përkatës të Kuvendit që monitoron shërbimet e pavarura dhe mendoj se i ka paraqitur siç duhet veprimtaritë kryesore që AKEP-i ka zhvilluar gjatë vitit të kaluar.

Njëkohësisht, në raport kemi paraqitur edhe një pasqyrë të zhvillimeve kryesore të tregut dhe kemi vënë disa pika për veprimtarinë tonë gjatë vitit që vijon. Dua t'ju them se e gjithë kjo punë është një punë e ristrukturuar mirëfilli, e cila bazohet në ligj dhe ka synuar në katër drejtime kryesore: krijimi i kushteve të favorshme për investitorët, nxitja e konkurrencës midis lojtarëve të tregut, mbrojtja e konsumatorit dhe realizimi i një efikasiteti të brendshëm të AKEP-it në partneritet me institucionet e tjera.

Sa i takon krijimit të kushteve të favorshme për investitorët, ne jemi plotësisht të përqendruar në këtë pikë, sepse besojmë se pa investime nuk mund të gëzojmë të mirat e shërbimeve moderne të komunikimeve elektronike, të cilat qytetarët shqiptarë duhet t'i gëzojnë në format më të mira që ofron teknologjia dhe kjo kërkon investime të vazhdueshme në mënyrë që të mos mbetemi pas.

Unë besoj se për deputetët e nderuar, por edhe për publikun, është i njohur fakti që shërbimet celulare shkojnë me gjenerata dhe sot në Shqipëri kemi arritur deri te gjenerata e katërt, ndërkohë që gjenerata e pestë është duke u implementuar në vende të ndryshme.

Për shembull, Zvicra javën që shkoi lëshoi një rrjet 5G dhe do të ishte diçka shumë e mirë që edhe Shqipëria të vijojë përgatitjet e saj për t'i implementuar sa më shpejt shërbimet e gjeneratës së pestë. Sigurisht, kjo kërkon një vëmendje të posaçme nga ana e institucioneve dhe AKEP-i është duke bërë pjesën e saj në këtë pikë dhe besoj se edhe nga komisioni juaj do të kemi mbështetje të plotë në mënyrë që brezat e frekuencave që përdoren në Europë për shërbimet 5G të mund të lirohen për t'u bërë të disponueshme për industrinë në vitin 2020, siç është edhe targeti i Bashkimit European.

Sa i takon nxitjes së konkurrencës, ne jemi përqendruar në krijimin e një ambienti sa më të drejtë për të gjithë operatorët në treg, pasi besojmë se duhet të kemi një strukturë tregu eficiente, e cila nuk favorizon një operator në kurriz të operatorëve të tjerë, por përkundrazi i lejon të gjithë operatorët të investojnë dhe të ndërtojnë shërbime në një ambient pozitiv. Kjo është një pjesë shumë e vështirë, zonja Gjermani, e cila u paraqit në problematikat e punës sonë dhe evidentoi një moment shumë të rëndësishëm, që ishte përmbyllja e analizave të tregut të shërbimeve celulare gjatë vitit të kaluar, një proces i bërë me mbështetjen maksimale të këtij komisioni, duke u bazuar edhe në rekomandimet e rezolutës së Kuvendit, proces, i cili u përmbyll nga AKEP-i, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi në fund të muajit shtator të vitit 2017, por për shkak të situatës dhe të reagimeve në treg na u desh ta rimarrim veprimtarinë tonë në këtë pikë dhe ta rinisim nga e para procesin. Pse?

Sepse, për fat të keq, reagimet nga lojtarë të caktuar të industrisë në Shqipëri ishin të tilla sa e bënë këtë gjë të nevojshme, edhe përtej faktit që analizat tona ishin të bazuara në praktikën më të mirë, ishin të diskutuara edhe me shërbimet e Komisionet European dhe kjo konfirmohet edhe nga procesverbali i Nënkomitetit Shqipëri-BE i mbajtur në datën 15 nëntor të vitit 2017.

Gjithsesi, pa humbur kohë, kemi nisur procesin e ri të analizave të tregut, proces i cili është në përmbylljen e tij. Kemi nxjerrë për konsultim publik dy dokumente të reja. Përsëri, në bashkëpunim me shërbimet e Komisionit European, do të arrijmë në konkluzione të gjithëpranuara, të cilat do t'i hapim rrugë marrjes së disa masave, që do të garantojnë prirjen pozitive që kemi zhvilluar gjatë vitit të kaluar për të siguruar konkurrencë në këto tregje.

Një nga çështjet e tjera prioritare është mbrojtja e konsumatorit. Zonja Gjermani përmendi disa arritje të rëndësishme në këtë drejtim. Ky është vetëm fillimi, nuk do të ndalemi në këtë drejtim. Kjo është dhe do të jetë fusha prioritare në veprimtarinë e AKEP-it gjatë vitit që do të vijë.

Në mbledhjen e këshillit drejtues të AKEP-it, që do të vazhdojë gjatë ditës së sotme, kemi në axhendë pikërisht hapjen e konsultimit publik për të gjitha termat e rishikuara të kontratave të pajtimtarëve dhe regjimit të ri të ofrimit të shërbimeve, me synimin që operatori dhe çdo pajtimtar individual, të mund të vijnë në pozita të barabarta në kushtet kontraktore që lidhin me njëri-tjetrin.

Njëkohësisht, synojmë që termat e kontratave të jenë sa më të thjeshta dhe të kuptueshme për pajtimtarët dhe çdo lloj abonimi të shoqërohet me këta terma, të cilat do t'u jepen në trajtë të shkruajtur pajtimtarëve nga ana e operatorëve.

Njëkohësisht, mbrojtja më e mirë për konsumatorin është në radhë të parë disponibiliteti i shërbimit. Gjatë vitit që do të vijë, do të bëjmë një monitorim edhe më të fortë të kushteve të mbulimit me shërbim në të gjithë territorin e vendit dhe për këtë kemi planifikuar edhe veprimtari specifike.

E njëjta gjë vlen të thuhet edhe për monitorimin nga ana jonë të sistemit të matjeve që kanë operatorët në mënyrë që t'u japim zë ankesave që pajtimtarët kanë lidhur me mbarimin e krediteve të tyre në telefoni, apo edhe për shërbime të internetit.

Lidhur me efikasitetin e brendshëm të AKEP-it, u përmend puna e mirë që kemi bërë për implementimin e strukturës, por kjo nuk mjafton. Objekti i punës sonë është performanca e AKEP-it si një institucion ekselence, në standard të njëjtë me të gjithë rregullatorët e vendeve të Bashkimit Europian, që punojnë në këtë fushë dhe në këtë pikë, gjatë vitit që do të vijë jemi duke përgatitur një set masash dhe trajnimesh në mënyrë që të rrisim kapacitetin e institucionit tonë dhe besoj se do të kemi edhe mbështetjen e këtij komisioni, në mënyrë që edhe mjetet që kemi në dispozicion, të jenë mjete të krahasueshme me rregullatorët e tjerë të vendeve të BE-së, por edhe të krahasueshme me industrinë që vet ne rregullojmë.

Dua t'ju garantoj edhe një herë lidhur me përgjegjshmërinë e Këshillit Drejtues së AKEP-it në realizimin e këtyre objektivave dhe të shpreh edhe një herë falënderimin për mbështetjen që na ka vënë në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit 2018 ky komision dhe Kuvendi.

Jam i gatshëm t'i përgjigjem çdo pyetje dhe sugjerimi që mund të ketë nga ana juaj.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Zela!

Ka pyetje apo komente për raportin nga anëtarët e komisionit?

Zoti Beqaj, fjala për ju.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Në fakt, nuk kam komente për raportin, por dua të çelim një diskutim për problematikat që vijnë nga prezantimi i raportit, sepse druham se trendi rënës i të ardhurave të operatorëve kryesorë të telefonisë mobile, i shoqëruar me norma shumë të ulëta fitimi, apo me fitime negative, për pasojë tkurrja e investimeve do të vijë duke e asfiksuar tregun në të ardhmen. Ne vërtet jemi të interesuar që t'i hapet rruga 5G-së dhe mund të bëjmë maksimumin për të zgjidhur procesin administrativ të frekuencës, por që operatorët të vijnë dhe të investojnë për 5G-në do të thotë se duhet të kenë interes ekonomik, ndërkohë që nga raportimet e tyre financiare deri më sot nuk e kanë një gjë të tillë. Unë personalisht mendoj se

vërtet mund të ketë një detyrim, që 5G-ja të bëhet gati në vitin 2020, por unë e shikoj Shqipërinë të përgatitur për IOT-të.

5G-ja nuk është për internetin që duan njerëzit, por është për makinat. Ne, si komision, me ndihmën e AKEP-it, mund të nxisim qeverinë që në sektorë të ndryshëm të industrisë së teknologjisë të vendosim edhe detyrimin ligjor që t'i paraprijmë IOT-së. Ne jemi të gatshëm, por unë një kërkesë të brendshme nuk e shikoj.

Megjithatë, edhe pse në pamje të parë raporti duket sikur situata në treg përgjithësisht nuk është e mirë, ka një tregues, të cilin unë e vlerësoj shumë pozitiv dhe që, në fakt, ecën me tendencën e të gjitha vendeve europiane. Praktikisht zëri dhe teksti prej vitesh janë biznes fundor dhe i vetmi biznes i pakufizuar tek të dhënat. Edhe pse raporti thotë se ka rënie të ardhurash, në fakt, rënia ka ardhur kryesisht te shumica dhe që sot duhet ta pranojmë se kanë qenë spekulative ndër vite. Thirrjet e ndërkombëtarëve kanë qenë për një biznes të fshehur, kanë qenë për një treg praktikisht biopol dhe shumë mirë që këto lloj të ardhurash kanë rënë. Për fat të keq, është rritur përqendrimi i tregut, madje sipas atij treguesi ndërkombëtar (të cilin nuk po e citoj se nuk dua ta citoj gabim dhe t'u jap shkas atyre që merren me emisionet e së dielës), ne jo vetëm që jemi të përqendruar, por jemi shumë herë mbi nivelin e përqendrimit. Këtu ka një të dhënë shumë interesante: edhe nëse numri i përdoruesve që operojnë *probend*-in ka rënë, totali i datave të lëvizura është rritur ndjeshëm. Pra, kanë qenë 4 milionë giga në vitin 2017, janë 4,7 milionë giga në vitin 2018. Kjo do të thotë se janë rreth 18% rritje në shfrytëzimin e *probend*-it. Për mendimin tim edhe rënia e numrit të pajtimtarëve nuk duhet parë me pesimizëm, sepse na pasqyron realitetin. Ne kemi pasur një periudhë të caktuar, një inflacion pajtimtarësh për sa banorë kishim, madje ne kishim më shumë se dy numra për banorë, duke futur kështu edhe moshën 1 vjeç edhe moshën 95 vjeç. Unë mendoj se ndoshta mund ta shikojmë përsëri rezolutën meqenëse jemi në nivel drafti.

Për sa u përket fibrave optikë më duket se jemi ende në një situatë jo të zhvilluar pozitivisht, sepse kemi 10 vjet që po i çajmë rrugët e Shqipërisë për të futur fibrat optikë, por praktikisht përveçse u bëmë me fjalë ndonjë përfitim nga shfrytëzimi i fibrave optike nuk është se kanë parë bizneset, administrata publike, qytetarët apo grupet e ndryshme të interesit. Edhe këtu me propozimin tuaj, si profesionistë, na thoni se çfarë mund të bëjmë edhe ne si deputetë, përveçse mund ta përfshijmë në rezolutë, sepse rezoluta vetëm një lloj indikacioni jep.

Me interes është edhe rritja e numrit të përdoruesve që shfrytëzojnë paketat e integruara 3 apo 4. Kam një pyetje për vete dhe për të gjithë, si do t'ia bëjmë me zhvillimin e

sektorit? Investimet e reja me atë çfarë kanë në bilance nuk i bëjnë dot, atëherë do t'i bëjnë duke i rritur tarifat, pra duke bërë hapa mbrapa, sepse direkt apo indirekt këto do të jenë kosto për konsumatorin. Pra, nëse biznesit do t'i rriten kostot, atëherë do të rriten kostot e mallrave dhe shërbimeve dhe konsumatori do t'i vuajë pasojat.

Po e mbyll me një pyetje, a ka vend për më shumë operator, apo do të rrimë me tre, pra si e shikoni?

Niko Peleshi – Po, zonja Gjermani!

Eglantina Gjermani – Edhe unë kam dy pyetje. E para lidhet me shërbimin postar. Meqenëse po shkojmë drejt digjitalizimit, ne i japim gjithmonë e më pak vëmendje, por në fakt posta përdoret në nivel kombëtar dhe ne e kemi rekomanduar për shërbimin universal postar. Lidhur me punën tuaj për vitin e kaluar, a mund të ndani diçka në mënyrë të përmblodhur, sepse është e vërtetë që posta përdoret në të gjithë Shqipërinë nga qytetarët, por edhe nga ata që mbase nuk kanë akses në internet apo mundësitë e tjera digjitale që ofrohen në qytete më të mëdha.

Pyetja tjetër është për mbulimin me rrjet të zonave rurale, pra cilat janë problematikat dhe si e shikoni të ardhmen?

Faleminderit!

Niko Peleshi – A ka pyetje, komente apo opinione të tjera?

Po, zoti Zela.

Ilir Zela – Faleminderit!

Zoti Beqaj preku çështje thelbësore të zhvillimit të këtij sektori, të cilat përfshijnë veprimtarinë e AKEP-it, por janë çështje që kanë të bëjnë me politikat e zhvillimit të këtij sektori gjithashtu.

Siç e tha zoti Beqaj, nuk ka vetëm një tregues pozitiv në prirjet që ka pasur industria gjatë vitit që kaloi, por ato reflektojnë insistimin e AKEP-it për ta lëvizur industrinë nga një gjendje problematike, ku operatorët kanë gjeneruar një pjesë të mirë të të ardhurave nga burime të paqëndrueshme, siç janë thirrjet hyrëse ndërkombëtare dhe ishin përfshirë në një luftë çmimesh lidhur me shërbimet e qëndrueshme që realizojnë nga shërbimet e pakicës, në një gjendje të shëndoshë, e cila është e lexueshme në raport dhe shfaqet me shifrat e rritjes së të ardhurave të operatorëve nga shërbimet e pakicës. Kjo arritje që e kalon këtë industri nga një industri me risk më të lartë, bazuar tek të ardhurat e paqëndrueshme të trafikut hyrës ndërkombëtar në një industri me risk më të ulët, e cila mund të përkthehet edhe në një mundësi më të madhe për investitorët, për ta parë atë më atraktive.

Me vijimin e kësaj prirjeje edhe për vitin që jemi e në vazhdim operatorët ekzistues, por edhe ata të rinjtë që mund të shfaqen, do të jenë në gjendje për të parë me interes investimet e reja në sektor. Kjo mund të kërkojë një kontribut më të madh nga publiku që i përdor këto shërbime, sepse mund të shfaqet edhe me një rritje relative të çmimeve. Por, nëse kjo rritje është e shëndetshme dhe nuk është abuzive me çmimet, pra justifikon një cilësi më të mirë shërbimi, atëherë është një përgjegjësi që konsumatorët shqiptarë duhet ta marrin, në mënyrë që të sigurojnë disponibilitetin e shërbimit, cilësinë e tij më të mirë dhe të gëzojnë përfitimet që realizon teknologjia. Në të kundërt ne rrezikojmë të mbetemi me shërbimet që ishin adekuate 10 vjet më parë, por që nuk janë shërbime, të cilat realizojnë nevojat e konsumatorëve sot. Ajo që kanë nevojë konsumatorët sot nuk është ajo që konsumatorët kanë nevojë nesër, pasi përhapja e 5G në vendet e BE-së, të cilat janë fqinje me ne, por edhe në vendet e rajonit, sigurisht që do t'i sjellë kërkesat për këto shërbime edhe në Shqipëri, ndaj edhe AKEP-i do të ketë kërkesë për këto shërbime në të njëjtën kohë edhe në Shqipëri, ashtu si në vendet e BE-së. Prandaj unë mendoj se duhet një përpjekje e koordinuar për të hapur brezat për këto shërbime, për të rritur penetrimin e fibrës në të gjithë territorin e vendit dhe për të realizuar investime të rëndësishme në sektor, të cilat nuk mund të vijnë vetëm nga operatorët që janë sot, por ka nevojë për angazhim projektesh me donatorë dhe për angazhim fondesh nga buxheti për të zgjeruar infrastrukturën e fibrës në Shqipëri. Ka disa iniciativa nga Ministria e Infrastrukturës për projekte me donatorë për zgjerim të rrjetit të fibrës në Shqipëri, por mendoj se ka më shumë hapësirë dhe nevojë për angazhim fondesh buxhetore, pasi nuk janë vetëm rrugët dhe infrastruktura që shihet, por ka plot infrastruktura të padukshme, të cilat duhet të jenë të sigurta dhe duhet të angazhojnë fonde publike për t'u bërë të disponueshme për publikun. Industria do të luajë rolin e vet dhe do të jetë në gjendje të investojë vetëm kur ajo të jetë e shëndoshë, të veprojë në një terren konkurrenca e mirëfilltë dhe të mos jetë e deformuar.

Lidhur me numrin e operatorëve në treg, ne nuk kemi vetëm 3, por kemi të paktën 140 operatorë, të cilët kanë regjistruar rrjetin në Republikën e Shqipërisë. Tre operatorë janë këta për shërbime celulare, por në qoftë se rrjetet e shërbimeve celulare hapen edhe ndaj operatorëve të tjerë, të cilët kanë rrjete fikse përmes një modeli biznesi që quhet *mobile virtual network coopeireitors*, menjëherë mund të shtohet numri i lojtarëve edhe në tregjet e celularëve, e cila mund të përkthehet në një konkurrencë akoma më të balancuar në treg. Operatorë klasikë, të cilët përdorin spektër sipas gjeneratave nga 2G deri në 4G në Shqipëri sot kemi 3. Sipas AKEP-it ky numër është optimal për funksionim normal të kësaj industrie dhe është një numër që në asnjë rrethanë nuk duhet të zvogëlohet më tej, por lejon mundësinë

edhe për hyrjen e lojtarëve të tjerë qoftë përmes modelit që sapo përmenda, qoftë edhe për operatorë të tjerë plotësisht të integruar. Reduktimi i mëtejshëm i këtij numri do të ishte problematik dhe do të na kthente në situata duopolistike, të cilat jo që nuk mund të kenë outpute eficiente, por do të kërkonin një mbikëqyrje dhe ndërhyrje shtetërore më të madhe sesa mund të bëjë vetë tregu kur numri i lojtarëve është më i gjerë në treg.

Lidhur me shërbimet postare, për ne është objekt pune i vazhdueshëm dhe kemi të njëjtin nivel vëmendje si për shërbimet e telekomunikacioneve, ashtu edhe për shërbimet postare. Kemi bërë inspektime të rëndësishme dhe kemi siguruar që shërbimet postare të mbështesin jo vetëm qytetarët, por edhe bizneset, pasi shumë biznese varen nga cilësia e shërbimeve postare në vend. Është pak a shumë e krahasueshme edhe me telekomunikacionet, që, ashtu siç varen bizneset nga pasja e shërbimeve të telekomunikacioneve të zhvilluara edhe shërbimi postar duhet të jetë i tillë.

Si rezultat i inspektimit që kemi realizuar kemi konstatuar se disa operatorë postarë nuk i realizojnë në kohë dhënien e kuotimeve për bizneset dhe për këtë arsye kemi marrë masa që çdo operator postar të jetë i detyruar që t'i kuotojë bizneset për shërbimet që kërkojnë brenda një afati të caktuar kohor të arsyeshëm. Njëkohësisht, nga inspektimi i kryer te Posta Shqiptare kemi lënë detyrë që dorëzimi i pakove të bëhet në adresën e individit. Kjo është shumë e rëndësishme, pasi është një kërkesë ligjore, po ashtu e kemi instruktuar Postën e Shqipërisë që të mos shtojë tarifa shtesë për njerëzit, të cilët, në vend që të marrin në adresë pakon, duhet që të shkojnë që ta tërheqin pakon në zyrat e postës, duke humbur kohë nga koha e tyre çmuar. Shpeshherë zyrat e postës janë edhe nëpër vende, që nuk janë shumë të aksesueshme nga njerëzit. Besoj se brenda 3-mujorit Posta Shqiptare do t'i marrë masat, në mënyrë që të sigurojë zbatimin korrekt të ligjit në këtë fushë. Edhe hapja e plotë tregut postarë do ta ballafaqojë Postën Shqiptare me konkurrencë të shtuar dhe do t'i lejojë operatorët e tjerë postarë të operojnë edhe në zona të rezervuara, të cilat janë për Postën Shqiptare.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Zoti Beqaj ka një tjetër ndërhyrje.

Ilir Beqaj – Faleminderit për prezantimin!

Më lindën dy pyetje nga ajo çfarë thatë. Për zhvillimin e këtyre operatorëve virtualë, sipas propozimit, a ka pengesë ligjore?

Ilir Zela – Jo, nuk ka pengesë ligjore.

Ilir Beqaj – A krijon një lloj deformimi në konkurrencën në treg fakti që nën Albtelekom janë në të njëjtin bilanc dy operatorë me licenca të ndryshme? Pra, a mund t'i përdorë të ardhurat pozitive të fiksit për të subvencionuar në mënyrë të fshehtë ato celulare, duke deformuar konkurrencën në treg?

Ilir Zela – Ky ka qenë objekti i vendimmarrjes së Autoritetit të Konkurrencës dhe AKEP-it në kohën që është realizuar bashkimi i dy kompanive dhe operacionet e Albtelekom-it janë subjekt i mbikëqyrjes sonë, por edhe Autoritetit të Konkurrencës lidhur me subvencionimin e tërthortë. Kështu që, nuk besoj se ka rrezik për këtë.

Është plotësisht e mundur që edhe operatorët e tjerë të telefonisë celulare mund të zhvillojnë operacione fiks, qoftë përmes zhvillimit të rrjetit të tyre fiks, qoftë përmes partneriteteve të ndryshme me operatorë, që kanë rrjetet fikse dhe kjo në njëfarë mënyre i vë në pozitë të barabartë operatorët në këtë drejtim. Ajo çfarë ne kemi parë dhe kemi reflektuar, që nga dalja në treg e “Plusit”, është se struktura jonë e industrisë mobile është problematike. Pse është problematike?! Sepse përqindjet e tregut që kanë operatorët celularë kanë evoluar në mënyrë të tillë, ku në njëfarë mënyrë bëjnë të nevojshme ndërhyrjen rregullatore ose mbikëqyrje të rreptë rregullatore, gjë që nuk është e këndshme edhe për vetë rregullatorin. Shumë vende i kanë evoluar industritë e tyre drejt pak a shumë balancës së vetvetishme në treg. Si realizohet? E kanë realizuar duke qenë të kujdesshëm, duke krijuar kushte të atilla, që operatorët të gëzojnë pjesë të përafërta ose të krahasueshme të tregut. Në këtë mënyrë ndërhyrjet janë më pak të nevojshme.

Struktura e tregut ka evoluar në mënyrë të tillë, që i ka mundësuar atyre të shkojnë në këto situata. Pra i është lënë më shumë dorë tregut të lirë për të lëvizur dhe ka pasur ndërhyrje rregullatore vetëm kur ato kanë qenë të domosdoshme, por ndërhyrjet kanë qenë decizive. Në Shqipëri ka ndodhur që disa nga këto ndërhyrje të jenë bërë të shfazuara, jo në kohën e duhur dhe na kanë dhënë një strukturë tregu, ku përqindjet e operatorëve në treg ndryshojnë shumë, nuk lejojnë këtë balancim dhe mbajnë sa më larg dorën rregullatore.

Niko Peleshi – Zoti Bitri.

Robert Bitri – Duke dëgjuar zotin Beqaj dhe kryetarin e AKEP-it, më zuri frika në pikëpamjen që vërtet duhen të ardhura për të bërë investime, por në përgjithësi AKEP-i e ka aftësinë që të kontrollojë. Është vërtet e nevojshme të hapen gjëra të reja, sepse për atë duhen investimet, pra për ta zhvilluar sa më mirë këtë biznes, por duhet të mos abuzohet, siç është abuzuar më parë me kostot e çmimeve, sepse në Shqipëri nga moskontrolli apo nga faktorët e tjerë eksperiencia na ka treguar se çmimet kanë qenë në stratosferë. Kështu, në momentet kur investimet e reja do të bëhen për ta zhvilluar më mirë sektorin, kjo kosto t'u vihet këtyre

bizneseve ose kësaj fushe të re të zhvillimit të këtij biznesi dhe jo t'u lihen gjërave të thjeshta, sepse operatori e ka shumë më të lehtë për të kompensuar fushën e re, zhvillimin e ri, ose investimet e reja. Prandaj pyetja është kjo: a jeni ju në gjendje ta kontrolloni, që këto investime të bëhen brenda atyre të ardhurave që garantojnë vetë këta investitorë në këtë fushë?

Niko Peleshi – Në vijim të pyetjes së zotit Bitri, në vlerësimin tuaj, kur do të jetë gati Shqipëria nga pikëpamja e tregut dhe nga pikëpamja infrastrukturore për të implementuar gjeneratën 5G?

E dyta, ju përmendët faktin e njohur gjerësisht që tre operatorët tanë nuk ndajnë pjesë të përafërta të tregut, por kanë shumë diferencë njëri nga tjetri. A luan roli AKEP-i në tregun me pakicë për t'i dhënë në njëfarë mënyrë oksigjen përafërimit të pjesëve të tregut, apo nuk është në misionin tuaj? Kam parasysh një përpjekje që bëtë vitin e kaluar, në mos gaboj në tetor, për tarifën asimetrike në tregun me pakicë.

Ilir Zela – Lidhur me mbulimin e zonave rurale dhe me cilësinë e sinjalit në këto zona, dëshiroj të shtoj që operatorët kanë kushte në licencat e tyre. Pra, është detyrë e AKEP-it të sigurohet që të zbatohen kushtet e këtyre licencave. Për këtë, siç paraqitet edhe në raport, ne kemi zhvilluar vjet disa monitorime. Konkluzioni është që kushtet e licencave të operatorëve zbatohen. Çështja për mbulimin është nëse zbatohen vetëm për shërbimet bazë apo zbatohen edhe për shërbimet e avancuara, të cilat vijnë edhe shtohen sipas gjeneratës së rrjetit. Në qoftë se detyrimet realizohen shumë mirë për 2G, pra për telefonatat dhe për sms-të, këto shërbime çalojnë kur vjen puna për 3G dhe 4G, pra për shërbimet e të dhënave, për shërbimet e internetit. Kjo lidhet edhe me koston e ofrimit të këtyre shërbimeve, sepse cilësia më e lartë, për fat të keq, kërkon edhe kosto më të larta. Gjithsesi, ne jemi duke u siguruar që të paktën këto shërbime të jenë konsistente me licencat që kanë operatorët. Për shembull, për shërbimet 4G, për të cilat kemi licencuar vetëm një operator, tani në brezat 800 megahercë, të cilat janë më eficientë dhe më të mirë për t'i ofruar këto shërbime, detyrimit për mbulim i shtohet edhe 5% e popullsisë, çka do të thotë se 25% e popullsisë së vendit nuk do të mundet që t'i gëzojë këto shërbime në këta terma. Pse? Sepse nuk e kemi vënë ne 100%. Kjo lidhet pikërisht me çfarë tha edhe zoti Berti: nëse ne do ta vëmë 100%, operatori nuk do të jetë në gjendje të investojë dhe jo vetëm nuk do të mbulohet 100%, por pa shërbim fare, sepse askush nuk do të investojë për t'i ofruar këto shërbime. Kështu që gjithmonë ka disa *trade off*-e, disa kompensime, që bëhen në mënyrë që të realizosh atë çfarë është më eficient, përndryshe dëmtohet e gjithë mundësia për investime. Prandaj unë them se nuk do të arrijmë t'i gëzojmë më të mirat që ofron teknologjia. Kjo i jep përgjigje edhe pyetjes së zotit Berti:

“A mundet që investime të tilla të na sigurojnë mosrritjen e çmimeve?”, çmimet edhe mund të rriten, por çështja është që çmimet të mos rriten në mënyrë abuzive. Kjo është detyra e AKEP-it, që të mos lejojë shtrëngesa të pajustificueshme në treg, të tilla që t’i detyrojnë njerëzit të paguajnë më shumë sesa është vlera e një shërbimi të caktuar apo se sa është kostoja e ofrimit të atij shërbimi, plus një fitim të arsyeshëm për kompaninë.

Në këtë pikë ne bëjmë një punë të studiuar: shohim numrat e operatorëve gjatë gjithë kohës, marrim raporte statistikore dhe i monitorojmë. Përveç të tjerash, në buxhetin e këtij viti kemi planifikuar edhe angazhimin e një konsulenti të huaj lidhur me këtë çështje për të parë me sa më shumë saktësi mënyrën e ofrimit të këtyre shërbimeve, pikërisht për të mos lejuar situata të tilla abuzive. Por çështja është që në Shqipëri, të paktën dy-tre vjetët e fundit, përpjekja e operatorëve është përqendruar te konkurrenca, ndoshta edhe e pandershme, për marrje pajtimtarësh nëpërmjet çmimeve pajustificueshmërisht të ulëta. Kjo e ka dëmtuar mundësinë e operatorëve për të investuar, sepse ato i kanë gjeneruar të ardhurat nga burime të pasigurta të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.

Lidhur me ndërhyrjen në *retail*, në tregun e pakicës, zoti Peleshi preku një çështje thelbësore, ka pasur një përpjekje të AKEP-it në vitin 2010 për të adresuar disa nga problemet me konkurrencën në treg nëpërmjet ndërhyrjeve në *retail*. Kjo nuk është metoda e preferuar nga AKEP-i. Pse? Sepse nuk është metodë efiçiente.

Referuar praktikave më të mira të BE-së, por edhe bindjes së AKEP-it, zgjidhja e problemeve me konkurrencën në treg duhet të vijë, në radhë të parë, nëpërmjet masave të shumicës. Çfarë janë masat e shumicës? Janë të tilla, që i detyrojnë operatorët që inputet e përdorura nga konkurrentët e tyre të mund t’i vënë në dispozicion të tyre njëloj siç ia vënë vetes së tyre. Kjo çon në situata të tilla, ku shërbimet e pakicës të mund të jenë efiçiente, të mund të gëzohen nga njerëzit me çmime sa më të ulëta dhe pa sjellë deformime në treg, pra abuzimin e pozitës së operatorit më të madh në kurriz të konsumatorëve, por edhe të pajtimtarëve të operatorëve me pjesë më të vogël të tregut.

Edhe në analizën e re të tregut që ne kemi zhvilluar kemi propozuar masa vetëm në nivelin e shumicës dhe jo masa në nivel të pakicës. Siç e thashë, kjo shkon në përputhje me praktikat e Bashkimit Europian.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera, komente ose opinione? Nuk ka?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shumë faleminderit, zoti Zela për prezantimin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër.

Siç e thamë, sot kryem vetëm dëgjesën me institucionin e AKEP-it, ndërkohë që në një mbledhje tjetër do të shqyrtojmë projektrezolutën, që do t'i paraqitet Kuvendit për miratim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju më keni thënë, zoti Bitri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen!

MBYLLET MBLEDHJA